



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-II.-13-0100-C0001

Paditësi:

Sh.G., Ferizaj

kundër

E paditura:

NP - Ferizaj

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Teuta Ibrahim, më 25 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion mbi këtë lëndë.

II. Lënda i kthehet Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 20.08.1991 Organi i Përkohshëm Punëdrejtues i N.SH. 'K' në Ferizaj përmes vendimit nr. 647 kishte refuzuar ankesën e paditësit Sh.G.t duke e lënë në fuqi aktvendimin nr. 632 të datës 15.08.1991.

Me këtë Aktvendim paditësit iu ishte ndërprerë marrëdhënia e tij e punës.

Më 24.09.1991 paditësi i lartpërmendur ka parashtruar kërkesë pranë Gjykatës Komunale në Ferizaj për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktvendimit nr. 632 të datës 15.08.1991 të Organit të Përkohshëm Punëdrejtues të N.SH. 'K' në Ferizaj.

Më 04.06.2012 Gjykata Komunale në Ferizaj nxjerr Aktvendimin nr. C. nr. 498/07 përmes së cilit shpallet Gjykatë Jokompetente në pikëpamje lëndore për të vepruar në këtë çështje juridike.

Më 15 gusht 2012 Gjykata Komunale në Ferizaj pas plotfuqishmërisë së Aktvendimit C. nr. 498/07, i dërgon të gjitha shkresat e kësaj lënde në Dhomën e Posaçme e cila pastaj merr numrin C-II.-13-0100-C0001.

Më 1 gusht 2017 Agjencia Kosovare e Privatizimit paraqet mbrojtjen e saj lidhur me padinë e paditësit Sh.G. kundër K – në Ferizaj.

AKP-ja përmes kësaj mbrojtjeje kërkon nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të tyre të merr Aktvendim për të refuzuar padinë e paditësit pasi që AKP-ja nuk ka legjitimitet pasiv.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi Ligjor:

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit të DHPGJSK.

Për shkak të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare nr. 13 e datës 30 maj 2012), Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk ka juridiksion mbi këtë lëndë.

Neni 23, pika 17, Lista 2, nën numrin 17 i Ligjit nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike, përcakton se SA në Ferizaj është 100% ndërmarrje publike.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji ka ndryshuar edhe statusi juridik i K- SA, Ferizaj.

Lënda duhet të dërgohet tek Gjykata Themelore në Ferizaj.

Për arsye të lartcekur gjykata nuk është lëshuar fare në merita lidhur me këtë çështje.

Andaj, për arsye të cituar më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshillë Juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim – Gjyqtare _____